



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 86, datë 26.04.2019**

**PËR**

**MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË AKTET RREGULLATIVE TË AMF-SË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**K O N S T A T O I S E:**

Si rezultat i ndryshimeve në Ligjin nr. 54/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” si dhe Vendimin e Bordit nr. 69, datë 19.06.2017 “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, nevojiten të bëhen rregullimet përkatëse në aktet rregullative të AMF-së, (rregullore/udhëzim);

Për sa më sipër,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e ndryshimeve në aktet rregullative të AMF-së:

- Rregullore nr. 14, datë 25.02.2009 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”;
- Rregullore nr.129, datë 26.11.2015 “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”;
- Rregullore nr.10, datë 25.01.2016 “Mbi funksionimin e bibliotekës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”;
- Rregullore nr.75, datë 30.05.2016 “Për komunikimin me median e publikun, publikimet dhe funksionimin e faqes së internetit”;
- Manual i Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku të Fondeve Vullnetare të Pensionit nr. 146, datë 29.09.2016;

- Udhëzim nr.62, datë 22.05.2008 “Për vlerësimin e arritjeve individuale të punonjësit”, sipas teksteve bashkëlidhur.

2. Ngarkohet Departamenti i Çështjeve Juridike, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Pajtim MELANI**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Ervin KOÇI**

**I. Në Rregulloren nr. 14, datë 25.02.2009** “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, në nenin 4, pika 3 dhe në nenin 9, pika 4, shprehja “Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse”

**II. Në Rregulloren nr.129, datë 26.11.2015** “Për marrëdhëniet e punës të punonjësve në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”:

- i. Në nenin 6, pikat 2, 3, 6, 10; në nenin 13, pikat 1, 4; në nenin 14, pika 3; në nenin 22, pikat 1, 2; në nenin 27, pika 3; në nenin 29, pika 1; në nenin 32, pika 1, 3; në nenin 34, në nenin 35, pika 2; në nenin 37, pikat 2, 3; në nenin 39, pika 4, shprehja “Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse”;
- ii. Kudo ku në këtë rregullore është shprehja “Sektori i Burimeve Njerëzore”, në fund i shtohet shprehja “dhe Protokoll-Arkivës”.

**III. Në Rregulloren nr.10, datë 25.01.2016** “Mbi funksionimin e bibliotekës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, në nenin 9, shkronja “c” dhe në nenin 10, shkronja “b”, shprehja “Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse”

**IV. Në Rregulloren nr.75, datë 30.05.2016** “Për komunikimin me median e publikun, publikimet dhe funksionimin e faqes së internetit”, bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 5:

- i. Në pikën 1, shprehja “Departamenti i Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës/Drejtoria e Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias”, zëvendësohet me shprehjen “Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”;
- ii. Në pikën 4, shprehja “Drejtoria e Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias”, zëvendësohet me shprehjen “Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”;

- iii. Në pikën 5, shprehja “Drejtorit të Departamentit të Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës”, zëvendësohet me shprehjen “Përgjegjësit të Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”;
  2. Në nenin 6, në pikat 3 dhe 4, shprehja “Departamenti i Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës”, zëvendësohet me shprehjen “Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”.
  3. Në nenin 8:
    - i. Në pikat 8 dhe 10 shprehja “Drejtoria e Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias”, zëvendësohet me shprehjen “Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”;
    - ii. Në pikën 10, shprehja “Drejtor i departamentit”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv”;
    - iii. Në pikën 11, shprehja “Drejtori i Departamentit të Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës, zëvendësohet me shprehjen “Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv”.
  4. Në nenin 9, pika 2, shprehja “Drejtoria e Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias”, zëvendësohet me shprehjen “Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”.
  5. Në nenin 10, pika 1, shprehja “Drejtorit të Departamentit, Drejtoria e Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”.
  6. Në nenin 11, pikat 4 dhe 7, shprehja “Drejtoria e Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias”, zëvendësohet me shprehjen “Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”.
  7. Në nenin 12:
    - i. Në pikën 1:
      - Shprehja “Sektori i Komunikimit me Median dhe Publikun” zëvendësohet me shprehjen “Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”;
      - Shprehja “nga Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimeve Strategjike Statistikës dhe Medias, miratimit nga Drejtori i Departamentit si dhe miratimit final”, hiqet.

- ii. Në pikën 3, shprehja “Departamenti i Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës”, zëvendësohet me shprehjen “Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”;
  - iii. Në pikën 4, shprehja “Drejtorisë së Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias zëvendësohet me shprehjen “Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”;
8. Në nenin 15:
- i. Në pikën I.1, shprehja “Departamenti i Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës”, zëvendësohet me shprehjen “Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”;
  - ii. Në pikën II, shprehja “Departamentit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Departamentit të Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës”, zëvendësohet me shprehjen “Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve”;
  - iii. Në pikën I.4, shprehja “Sektori i Statistikës, pjesë e Drejtorisë së Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtoria e Statistikës”;
  - iv. Në pikat I.5 dhe I.6, I.7, I.8, shprehjet “sektori i statistikës” dhe “Drejtorisë së Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias” zëvendësohen me shprehjen “Drejtoria e Statistikës”;
  - v. Në pikën I.9:
    - Shprehja “Departamentit të Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës”, zëvendësohet me shprehjen “Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve”;
    - Shprehja “Drejtorisë së Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias” zëvendësohet me shprehjen “Drejtorisë së Statistikës”;
9. Në nenin 16

- Shprehja “Departamenti i Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës”, zëvendësohet me shprehjen “Departamenti i Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve”;
- Shprehja “Sektori i statistikës”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtoria e Statistikës”;

10. Në nenin 17:

- Në pikën 1, shprehja “Drejtoria e Zhvillimeve Strategjike, Statistikës dhe Medias”, zëvendësohet me shprehjen “Zyra e Marrëdhënieve me Publikun dhe Median”;
- Në pikën 6, shprehja “Departamentit të Zhvillimeve Strategjike, TI dhe Statistikës”, zëvendësohet me shprehjen “Departamentit të Zhvillimeve Strategjike dhe Operacioneve”.

**V. Në Manualin e Mbikëqyrjes me Bazë Rreziku të Fondeve Vullnetare të Pensionit nr. 146, datë 29.09.2016, bëhen këto ndryshime:**

1. Në pikën 1.31:

- Shprehja “Departamentit të Mbikëqyrjes”, zëvendësohet me shprehjen “Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve”;
- Shprehja “Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Fondeve të Pensioneve dhe Investimeve”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve”;
- Shprehja “Drejtorisë së Sigurimeve”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve”;
- Shprehja “Drejtorisë së Zhvillimit Strategjik, TI-së dhe Statistikave”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtorisë së Statistikës”;
- Shprehja “Drejtori i Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit ose Përfaqësues i Drejtorisë”, zëvendësohet me shprehjen “Përgjegjësi i zyrës së licencimit në Departamentin e Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve ose Përfaqësues i Zyrës”;

- vi. Shprehja “Drejtorisë Juridike”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtorisë Juridike dhe Integritet”;
- vii. Shprehja “Përfaqësues nga Qendra e Edukimit”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtori i Drejtorisë së Mbrojtjes Konsumatore”.

2. Në pikën 2.11 shprehja “Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Fondeve të Pensioneve dhe Investimeve”, zëvendësohet me shprehjen “Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve”;

3. Në pikën 2.64:

- Shprehja “Drejtorinë e Komunikimeve”, zëvendësohet me shprehjen “Zyrën e Marrëdhënieve me Mediat dhe Publikun”;
- Shprehja “Drejtorinë Kërkimore”, zëvendësohet me “Drejtorinë e Kërkimeve dhe Zhvillimeve Strategjike”

**VI. Në Udhëzimin nr.62, datë 22.05.2008** “Për vlerësimin e arritjeve individuale të punonjësit”, kudo ku në këtë udhëzim është shprehja “Sektori i Burimeve Njerëzore”, në fund i shtohet shprehja “dhe Protokoll-Arkivës”.